



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 09.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "IBM SHPK&NPT MALI" për aktivitetin: "Furnizimi me inventar" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1293-111 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Burimi Dekor" e datës 07.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me inventar" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1293-111, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 02.07.2020, te publikuar në web-faqe te KRPP-së.

1. Anulohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.07.2020 dhe aktiviteti kthehet në rivleresim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**NTP Burimi Dekor**" me datë 06.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi me inventar**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1239-111

Autoriteti Kontraktues, me datë 09.07.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet tuaja për mosplotesimin e kërkesave-referencave nga dy OE-ik: "Blendi dhe Mediatech" janë pjesërisht të arsyeshme, pasi që i pari nuk e plotëson këtë kriter ndërsa për të dytin është dashur të verifikohen nëpërmjet sqarimeve me shkrim, për faktin se dëshmitë e dorezimit të mallrave janë të vullosura nga dorezuesi i mallit dhe jo nga pranuesi dhe se të njëjtat përputhen me të dhënat në librin e shitjes, por për t'i saktësuar është dashur të kerkohen dëshmitë e transaksioneve bankare;

-Pretendimet lidhur me mungesen e dorezimit te specifikimeve teknike nga OE-ik"Blendi"dhe Media Tech"jane te bazuara,pasi qe ata kane dorezuar vetem specifikimet e paraqitura ne dosjen e tenderit dhe i kane paraqitur si specifikime te vetat edhe pse ne piken 9.2 eshte kerkuar se OE-ik duhet te dorezojne specifikimet teknike per artikujt e ofruar duke i nenvizuar produktet qe ofrohen dhe per kete pretendimi i juaj se AK-ja eshte dashte te kerkoj sqarime eshte i bazuar;

Pretendimi tjetër se dy OE-ik"Blendi"dhe "Mediatech" nuk e ka te regjistruar veprimtarine perkatese qe lidhet me furnizimet ne kete aktivitet eshte i bazuar,por ju sqarojme se AK-ja nuk e ka kerkuar decidivisht kete dhe bazuar ne faktin se ata kane deshmi per furnizime te tilla nuk paraqet ndonje shmangje substanciale;

-Pretendimi se OE-ik "Blendi" nuk e ploteson kriterin e percaktuar te referencave dhe per kete arsye edhe i eshte kerkuar sqarim plotesues,por komisioni nuk ka verejtur se ne sqarimet plotesuese i njejti ka deguar si deshmi nje reference me data te ndryshuara(data 02.03.2020) dhe me te dhena te njejta me referencen e dorezuar ne tender(data 27.12.2018 vlera 7,569.00 €).Bazuar ne kete dhe ne faktin se nje reference ka te beje me furnizimin me paisje sportive rrjedh se ky OE-ik"Blendi" nuk ploteson kerkesen e deshmive per realizim te furnizimeve te ngjajshme(furnizim me inventar)ne vleren e kerkuar;

-Poashtu pretendimi lidhur me mosperputhjen ne mes te references dhe vleres se paraqitur te kontrates ne liste eshte i bazuar dhe kjo eshte dashte te sqarohet;

-Poashtu pretendimi per mosperputhje ne mes te listes se kontratave dhe deshmive te dorezuara pas sqarimeve eshte i bazuar dhe se kjo mosperputhje eshte dashte te sqarohet nga komisioni i vleresimit.

-Pretendimi juaj se te OE-ik "Burimi Dekor "mungon deklarata per garancion per periudhen nje vjecare eshte e bazuar,por kjo deklarate nuk eshte kerkuar dhe pasi qe eshte kerkese ne kushtet e veqanta nuk ka rendesi ne kete faze te aktivitetit qe d.t.th.se kjo eshte e lidhur me obligimin e fituesit te tenderit.

Nga konstatimet paraprake rrjedh se ne fazen e rivleresimit duhet te sqarohen te gjitha pa qartesite e cekura me larte.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

